

Statistika mbi ngjarjet demografike të ndërmarrjeve, 2021-2023

Tiranë, më 5 May 2025: INSTAT publikon për herë të parë të dhëna mbi demografinë e ndërmarrjeve në Shqipëri, për periudhën 2021-2023.

Ky publikim ofron një panoramë të zhvillimeve të ndërmarrjeve gjatë viteve 2021-2023, duke përfshirë numrin e ndërmarrjeve aktive, të reja dhe të mbyllura. Gjithashtu, paraqiten të dhëna mbi strukturën e punësimit në këto ndërmarrje, duke evidentuar aktivitetet ekonomike ku ato janë më të përqendruara, si dhe shpërndarjen sipas madhësisë, bazuar në numrin e të punësuarve me pagesë.

Përpilimi i të dhënave statistikore mbi demografinë e ndërmarrjeve bazohet në analizën dhe përpunimin e të dhënave të Regjistratit Statistikor të Ndërmarrjeve (RSN). Aktivitetet ekonomike të mbuluara përfshijnë seksionet B deri në N dhe P deri në R, si dhe ndarjet S95 dhe S96 të Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike NVE Rev.2.

Në vitin 2023:

- Numri i ndërmarrjeve aktive ishte 125.736;
- Numri ndërmarrjeve të reja ishte 13.346;
- Numri i ndërmarrjeve të mbyllura ishte 810.

Tab. 1 Numri i ndërmarrjeve sipas statusit të aktivitetit, 2021-2023

Statusi i aktivitetit të ndërmarrjes	2021	2022	2023
Ndërmarrje aktive	114.191	120.587	125.736
Ndërmarrje të reja	14.509	15.261	13.346
Ndërmarrje të mbyllura	1.003	565	810

Burimi: INSTAT, Regjistrat e biznesit

Aktivitetet ekonomike me përqindjen më të madhe të ndërmarrjeve aktive gjatë vitit 2023 ishin:

- Tregtia me shumicë dhe me pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe motorçikletave, me 35,2 %;
- Akomodimi dhe shërbimi ushqimor me 14,3 %;
- Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike me 7,9 %.

Aktivitetet ekonomike me përqindjen më të lartë të **punësimit** gjatë 2023 ishin:

- Tregtia me shumicë dhe me pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe motorçikletave, me 21,8 %;
- Industria përpunuese me 15,5 %
- Ndërtimi me 9,1 %.

Tab. 2 Struktura në përqindje e numrit të ndërmarrjeve aktive dhe punësimit sipas seksioneve, 2021-2023

Aktiviteti ekonomik	2021		2022		2023	
	Ndërmarrje aktive	Të punësuar	Ndërmarrje aktive	Të punësuar	Ndërmarrje aktive	Të punësuar
Gjithsej	100	100	100	100	100	100
B Industria nxjerrëse	0,7	1,5	0,6	1,4	0,6	1,5
C Industria përpunuese	6,5	16,0	6,4	16,1	6,4	15,5
D Energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar	0,5	1,7	0,4	1,8	0,5	1,8
E Furnizimi me ujë, aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	0,3	2,2	0,2	2,0	0,2	2,0
F Ndërtimi	4,8	8,7	5,2	8,9	5,5	9,1
G Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motorçikletave	37,7	21,3	36,4	21,9	35,2	21,8
H Transporti dhe magazinimi	5,0	3,6	5,0	3,7	5,1	3,8
I Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	15,0	8,0	14,5	7,9	14,3	8,2
J Informacioni dhe komunikacioni	3,5	3,7	4,0	4,0	4,3	4,2
K Aktivitete financiare dhe të sigurimit	0,9	2,2	1,0	2,2	1,2	2,2
L Aktivitete të pasurive të paluajtshme (real estate)	1,0	0,5	1,3	0,6	1,4	0,6
M Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	7,3	4,1	7,7	4,3	7,9	4,3
N Shërbime administrative dhe mbështetëse	3,5	6,8	3,9	6,3	4,2	6,2
P Arsimiti	1,2	9,7	1,1	8,9	1,1	8,6
Q Shëndeti dhe aktivitete të punës sociale	3,7	6,7	3,8	6,7	3,8	6,7
R Arte, argëtim dhe çlodhje	1,2	1,0	1,3	1,1	1,3	1,1
S Aktivitete të tjera shërbimi	7,3	2,2	7,1	2,3	7,0	2,4

Burimi: INSTAT, Regjistrat e biznesit

Në vitin 2023, aktivitetet ekonomike me përqindjen më të madhe të **ndërmarrjeve të reja** ishin:

- Tregtia me shumicë dhe me pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe motorçikletave, me 26,2 %;
- Akomodimi dhe shërbimi ushqimor me 13,3 %;
- Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike me 8,8 %.

Aktivitetet ekonomike me përqindjen më të lartë të **punësimit të ndërmarrjeve të reja** gjatë vitit 2023:

- Tregtia me shumicë dhe me pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe motorçikletave, me 20,9 %;
- Akomodimi dhe shërbimi ushqimor me 14,0 %;
- Ndërtimi me 11,2 %.

Tab. 3 Struktura në përqindje e numrit të ndërmarrjeve të reja dhe punësimit sipas seksioneve, 2021-2023

Aktiviteti Ekonomik	2021		2022		2023	
	Ndërmarrje të reja	Të punësuar	Ndërmarrje të reja	Të punësuar	Ndërmarrje të reja	Të punësuar
Gjithsej	100	100	100	100	100	100
B Industria nxjerrëse	0,2	0,1	0,2	0,3	0,2	0,5
C Industria përpunuese	4,7	10,0	5,5	11,5	5,2	8,3
D Energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar	0,6	0,3	0,3	0,2	0,9	0,7
E Furnizimi me ujë, aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	0,2	0,2	0,3	1,7	0,2	1,8
F Ndërtimi	6,4	8,2	7,2	9,5	7,9	11,2
G Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motorçikletave	30,8	21,4	27,3	22,1	26,2	20,9
H Transporti dhe magazinimi	3,8	3,0	4,3	3,5	4,7	3,6
I Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	13,4	14,0	12,8	13,1	13,3	14,0
J Informacioni dhe komunikacioni	8,6	11,1	9,4	8,6	8,2	9,0
K Aktivitete financiare dhe të sigurimit	1,4	0,9	1,5	0,9	2,3	1,4
L Aktivitete të pasurive të paluajtshme (real estate)	2,1	1,3	2,9	1,8	2,7	1,8
M Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	9,8	9,6	10,1	9,8	8,8	7,4
N Shërbime administrative dhe mbështetëse	6,0	10,0	6,7	7,5	7,8	8,0
P Arsimimi	0,9	1,8	0,8	0,9	0,6	2,2
Q Shëndeti dhe aktivitete të punës sociale	4,0	3,7	3,2	3,0	3,2	3,3
R Arte, argëtim dhe çlodhje	1,8	1,3	1,7	1,5	1,8	1,3
S Aktivitete të tjera shërbimi	5,2	3,2	6,0	4,2	6,0	4,4

Burimi: INSTAT, Regjistrat e biznesit

Gjatë vitit 2023, aktivitetet ekonomike me përqindjen më të madhe të **ndërmarrjeve aktive sipas madhësisë së tyre**, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

- 51,1 % e ndërmarrjeve aktive rezultojnë pa të punësuar me pagesë;
- 37,1% e ndërmarrjeve aktive rezultojnë me 1-4 të punësuar me pagesë;
- 5,4 % e ndërmarrjeve aktive rezultojnë me 5-9 të punësuar me pagesë;
- 6,4 % e ndërmarrjeve aktive rezultojnë me 10 ose më shumë të punësuar me pagesë.

Tab. 4 Struktura në përqindje e numrit të ndërmarrjeve aktive dhe ndërmarrjeve të reja sipas seksioneve dhe madhësisë së ndërmarrjes, 2023

Aktiviteti Ekonomik	Ndërmarrje aktive				Ndërmarrje të reja			
	0 të punësuar	1-4 të punësuar	5-9 të punësuar	>=10 të punësuar	0 të punësuar	1-4 të punësuar	5-9 të punësuar	>=10 të punësuar
Gjithsej	51,1	37,1	5,4	6,4	56,1	38,6	3,3	2,0
B Industria nxjerrëse	14,8	49,0	15,7	20,5	21,2	57,6	9,1	12,1
C Industria përpunuese	33,3	40,3	9,5	16,9	44,6	43,3	5,2	6,9
D Energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar	4,4	68,7	11,5	15,4	4,3	94,0	0,9	0,9
E Furnizimi me ujë, aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	19,0	37,7	7,2	36,1	29,6	63,0	3,7	3,7
F Ndërtimi	22,5	50,6	11,7	15,2	33,5	54,3	7,5	4,7
G Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motorçikletave	54,8	36,3	4,6	4,4	60,4	36,9	1,6	1,1
H Transporti dhe magazinimi	66,9	24,5	4,1	4,4	68,0	28,2	2,7	1,1
I Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	54,5	35,9	5,8	3,8	55,4	36,8	6,1	1,7
J Informacioni dhe komunikacioni	56,2	32,3	4,7	6,7	66,3	28,8	2,4	2,5
K Aktivitete financiare dhe të sigurimit	41,9	48,5	5,1	4,4	54,2	43,9	1,6	0,3
L Aktivitete të pasurive të paluajtshme (real estate)	45,6	48,0	3,9	2,5	48,2	50,4	0,6	0,8
M Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	55,8	36,7	3,9	3,5	59,5	36,1	2,8	1,5
N Shërbime administrative dhe mbështetëse	43,7	43,3	5,4	7,6	55,6	39,5	2,5	2,4
P Arsimiti	21,0	44,5	11,8	22,7	51,8	33,7	6,0	8,4
Q Shëndeti dhe aktivitete të punës sociale	42,1	38,1	6,1	13,7	48,0	45,2	5,2	1,6
R Arte, argëtim dhe çlodhje	51,6	37,8	3,8	6,8	58,4	38,8	2,4	0,4
S Aktivitete të tjera shërbimi	68,0	29,4	1,8	0,8	68,4	29,7	1,3	0,6

Burimi: INSTAT, Regjistrat e biznesit

Gjatë vitit 2023, aktivitetet ekonomike me përqindjen më të madhe të **ndërmarrjeve të mbyllura sipas madhësisë së tyre**, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

- 61,5 % e ndërmarrjeve të mbyllura rezultojnë pa të punësuar me pagesë;
- 28,5 % e ndërmarrjeve të mbyllura rezultojnë me 1-4 të punësuar me pagesë;
- 4,6 % e ndërmarrjeve të mbyllura rezultojnë me 5-9 të punësuar me pagesë;
- 5,4 % e ndërmarrjeve të mbyllura rezultojnë me 10 ose më shumë të punësuar me pagesë.

Tab. 5 Struktura në përqindje e numrit të ndërmarrjeve të mbyllura sipas seksioneve dhe madhësisë së ndërmarrjes, 2023

Aktiviteti Ekonomik	Ndërmarrje të mbyllura >=10 të punësuar			
	0 të punësuar	1-4 të punësuar	5-9 të punësuar	>=10 të punësuar
Gjithsej	61,5	28,5	4,6	5,4
B Industria nxjerrëse	C	C	-	-
C Industria përpunuese	50,9	38,6	5,3	5,3
D	-	-	-	-
E Furnizimi me ujë, aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	C	-	-	C
F Ndërtimi	33,3	39,4	C	C
G Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motorcikletave	67,2	29,2	2,5	1,1
H Transporti dhe magazinimi	70,6	C	-	C
I Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	66,9	22,8	7,9	2,4
J Informacioni dhe komunikacioni	51,6	29,0	C	C
K Aktivitete financiare dhe të sigurimit	C	C	-	-
L Aktivitete të pasurive të paluajtshme (real estate)	C	C	C	-
M Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	66,7	28,2	C	C
N Shërbime administrative dhe mbështetëse	37,5	45,8	-	16,7
P Arsimimi	33,3	C	-	C
Q Shëndeti dhe aktivitete të punës sociale	30,4	C	39,1	C
R Arte, argëtim dhe çlodhje	58,3	C	-	C
S Aktivitete të tjera shërbimi	66,7	C	-	C

Burimi: INSTAT, Regjistrat e biznesit

Shënim: C – Detajimi i mëtejshëm cënon konfidencialitetin

Metodologjia

Publikimi “Statistika mbi ngjarjet demografike të ndërmarrjeve” luan një rol kyç me informacione të dobishme në mbështetje të grupeve të interesit, përfshirë bashkësinë e biznesit, politikëbërësit dhe akademikët. Duke analizuar të dhënat mbi ndërmarrjet, ky publikim mundëson marrjen e vendimeve mbi baza të informuara dhe ndihmon në nxitjen e zhvillimit ekonomik.

Baza ligjore

- Ligj nr. 17/2018 datë 5.4.2018 “Për statistikat zyrtare”;
- Rregullorja e Parlamentit dhe Këshillit Evropian (BE) 2019/2152 e datës 27 nëntor 2019, mbi “Statistikat Evropiane të Biznesit”;
- Ligji nr. 30/2022 datë 24.03.2022 “Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave për “Për miratimin e nomenklaturës së veprimtarive ekonomike të revizionuar (Rev. 2)” Nr. 320 datë 28.5.2014;

Përpilimi i të dhënave statistikore mbi demografinë e ndërmarrjeve bazohet në analizën dhe përpunimin e të dhënave të Regjistrit Statistikor të Ndërmarrjeve (SBR).

Aktiviteti ekonomik i ndërmarrjes bazohet në Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike NVE Rev.2. Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike (NVE), është klasifikim në nivel katërshifror i veprimtarive ekonomike të ushtruara nga ndërmarrjet. Kjo nomenklaturë është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, Nr.320 datë 28.5.2014 dhe është përkthimi dhe përshtatja e Nomenklaturës së Aktiviteteve Ekonomike të Komunitetit Evropian NACE Rev.2. Aktivitetet ekonomike të mbuluara në këtë publikim përfshijnë seksionet B deri në N dhe P deri në R, si dhe ndarjet S95 dhe S96 të klasifikimit NVE Rev.2.

Përkufizime të variablave

Ndërmarrja është: “kombinimi më i vogël i njësisve ligjore pra një njësi organizative e cila prodhon të mira apo shërbime dhe ka një farë autonomie në marrjen e vendimeve, veçanërisht për shpërndarjen e burimeve aktuale të saj. Ndërmarrja kryen një ose me shumë aktivitete në një apo më shumë vendndodhje (njësi lokale)”. Marrëdhënia mes një ndërmarrje dhe një njësie ligjore përkufizohet si: “ndërmarrja i korrespondon ose një njësie ligjore ose një kombinimi njësisish ligjore”.

Të punësuarit përfshijnë të gjithë personat që punojnë në ndërmarrje përfshirë pronarët, të punësuarit me pagesë si dhe pjestarët e familjes të papaguar.

Të punësuar me pagë janë të gjithë personat që punojnë drejtpërdrejtë me ndërmarrjen në bazë të kontratës së punës dhe marrin kompensim në formën e pagave, shpërblimeve etj.

Statistikat e demografisë së ndërmarrjeve përfshijnë ndërmarrjet aktive, ndërmarrjet e reja dhe ndërmarrjet e mbyllura të cilat përcaktohen si më poshtë:

Ndërmarrje aktive: Numri i njësive statistikore të cilat, në çdo moment gjatë periudhës referuese, janë konsideruar “ndërmarrje” dhe që kanë qenë aktive gjatë të njëjtës periudhë (kanë realizuar shitje ose kanë punësuar staf).

Ndërmarrje të reja: Një ndërmarrje konsiderohet e re kur ajo regjistrohet për herë të parë dhe fillon aktivitetin ekonomik, duke përfaqësuar krijimin e një kombinimi të faktorëve të prodhimit.

Ndërmarrje të mbyllura: Një ndërmarrje konsiderohet e mbyllur kur ndalet përfundimisht aktiviteti i saj ekonomik, duke u shpërbërë kombinimi i faktorëve të prodhimit.